



UNMIK

MEM

MINISTRIA E ENERGISË DHE MINIERAVE
MINISTARSTVO ENERGIJE I RUDARSTVA
MINISTRY OF ENERGY AND MINING



INSTITUCIONET E PËRKOHSHME VETËQEVERISËSE
PRIVREMENE INSTITUCIJE SAMOUPRAVLJANJA
PROVISIONAL INSTITUTIONS OF SELF-GOVERNMENT

QEVERIA E KOSOVËS

VLADA KOSOVA

GOVERNMENT OF KOSOVO

MINISTRIA E ENERGISË
DHE MINIERAVE

MINISTARSTVO ENERGIJE
I RUDARSTVA

MINISTRY OF ENERGY
AND MINING

Qeveria e Kosovës,

Në pajtim me Kapitulln 8, Nenet 30 dhe 31 të Ligjit për Energjinë, Nr. 2004/8.

Në bazë të Rregullores nr. 2001/9, të datës 15 Maj 2001, mbi Kornizën Kushtetuese për Vetëqeverisjen e Përkohshme në Kosovë dhe Rregullores, Nr. 2001/19, mbi Degën e Ekzekutivit të Institucioneve të Përkohshme të Vetëqeverisjes në Kosovë, siç është amendamentuar me Rregulloren nr. 2002/5 dhe me Rregulloren nr. 2005/15.

Miraton këtë :

UDHËZIM ADMINISTRATIV

Nr. 2005/7

MBI RREGULLAT PËR ZONAT E SIGURISË

Neni 1

Përkufizimet dhe Interpretimi

“Ministri” Ministri i Energjisë dhe Minierave

“Ministria” Ministria e Energjisë dhe Minierave

“Ndërtimi” nënkupton ngritjen, instalimin, zëvendësimin, renovimin, zgjerimin, ndryshimin, shëndrrimin, apo rrënimin e çfarëdo ndërtese, ose objekti, duke përjashtuar punët rutinore që duhet të kryhen për mirëmbajtjen e ndërtesave, apo objekteve dhe duke përjashtuar punët e specifikuar nga autoriteti kompetent komunal, në instruksionet komunale, për të cilat nuk kërkohet leje ndërtimi.

“Pika shpërndarëse e ngrohjes” nënkupton pikën ku ndërmarrjet e ngrohjes furnizojnë bartësin e ngrohjes për konsumatorët (gypat furnizuese dhe kthyes) dhe ku ngrohja matet me pajisjen matëse, para dërgimit të bartësit të ngrohjes në sistemin vetanak sekondar të konsumatorit. Pikë momentale shpërndarëse është i ashtuaquajturi nënstation, ku ngrohja, nga rrjeti i furnizuesit bartet në rrjetin e konsumatorit dhe ku prodhohet uji i ngrohtë.

“Stabilimenti energjetik” nënkupton instalimin e pajisjeve për prodhim, apo centralin e energjisë elektrike, si dhe rrjetin dhe instalimet ndihmëse, rrjetin e bartjes dhe stacionet e tij transformuese, sistemet shpërndarëse, pajisjen e lidhur direkt te konsumatori, qarqet ndërlidhëse dhe linjat direkte.

“Ndërmarrja për energji” nënkupton ndërmarrjen energjetike që kryen një, apo më shumë aktivitete të mëposhtme energjetike: prodhim, transformim, bartje, shpërndarje, furnizim, shitblerje, apo depozitim të energjisë elektrike, energjisë së ngrohjes, apo të gazit natyror, në bazë të licencës së lëshuar në bazë të Ligjit për Rregullatorin e Energjisë, apo pa licencë, nëse ajo nuk është e nevojshme.

“Ngrohja” nënkupton energjinë e ngrohjes qendrore, apo të klimatizimit qendror, të transportuar përmes bartësit të energjisë së ngrohjes, nga prodhuesi deri te

konsumatori, për mirëmbajtjen e temperaturës shtëpiake të konsumatorit në nivelin e duhur dhe për furnizimin me e ujë të ngrohtë industrial dhe/apo me ujë të ngrohtë shtëpiak.

“Ndërmarrja për ngrohje” nënkupton entitetin ligjor që kryen, një apo më shumë aktivitete të prodhimit, distribuimit apo furnizimit me energji të ngrohjes, në bazë të licencës së dhënë, si dhe prodhuesit e energjisë së ngrohjes, të lidhur në Sistemin e Ngrhjes, të liruar nga licenca, sipas përcaktimit në Ligjin për Energjinë, nr. 2004/8.

“Sistemi i Ngrhjes” nënkupton sistemin e integruar dhe të ndërlidhur të prodhimit, distribuimit dhe furnizimit me energji të ngrohjes.

“Pronar, qiraxhi apo kujdestar i tokës” nënkupton pronarin, apo shfrytëzuesin e tokës që gjendet brenda Zonës së Sigurisë, të përcaktuar në Nenin 31 të Ligjit për Energjinë nr. 2004/8.

Fjalët e një gjinie të përdorura në këtë Udhëzim Administrativ , do të përfshijnë edhe gjininë tjetër, dhe fjalët e përdorura në numrin njëjës do të përfshijnë edhe shumësin, dhe shumësi do të përfshijë edhe njëjësin.

Përkufizimet tjera themelore, të përdorura në këtë Udhëzim Administrativ, do të kenë kuptimet e përkufizuara në Nenin 3 të Ligjit për Energjinë, nr. 2004/8 dhe në Nenin 3 të Ligjit për Energjinë Elektrike dhe në legjislacionin mbi ngrohjen qendrore.

Neni 2

Qëllimi dhe Fushëveprimi

2.1. Territoret në afërsi të drejtpërdrejtë të stabilimenteve energjetike (duke përfshirë, por duke mos u kufizuar në ndërtesa, instalime, linja komunikimi, linja bartje dhe distribuimi, gypa etj.), janë të mbrojtura nga Zonat e Sigurisë. Themelimi i Zonave të Sigurisë, përreth stabilimenteve energjetike, ka për qëllim sigurimin e

operimit normal të objekteve energjetike, sigurinë e personelit dhe qytetarëve të tjerë, si dhe sigurinë e entiteteve të tjera.

2.2. Qëllimi i këtij Udhëzimi Administrativ është:

- a) Përcaktimi i lokacionit, madhësisë, kufijve dhe regjimit të Zonave të Sigurisë, përreth stabilimenteve energjetike;
- b) Përcaktimi i të drejtave dhe detyrimeve të pronarëve të pronave, në të cilat gjenden stabilimentet energjetike dhe objektet e ndërlidhura me të;
- c) Përcaktimi i kriterëve dhe kushteve, në bazë të të cilave bëhet evitimi i ndërtimit të paligjshëm, apo përfundimi i kryerjes së aktiviteteve të paligjshme, nga pronarët, apo shfrytëzuesit, në Zona të Sigurisë përreth stabilimenteve energjetike.

Neni 3

Dispozitat e Përgjithshme

3.1. Zonat e Sigurisë janë të identifikuara:

- a) Në Planin Hapësinor për Zonat Speciale, në pajtim me dispozitat e parapara në Nenin 12 të Ligjit për Planifikimin Hapësinor, nr. 2003/14.
- b) Në planet komunale për zhvillim, në planet urbane për zhvillim dhe në planet urbane për rregullim, në pajtim me dispozitat e parapara në nenin 10 të Ligjit për Planifikimin Hapësinor nr. 2003/14.

3.2. Në Zonat e Sigurisë, asnjë veprim apo mosveprim, nuk duhet ta parandalojë, apo ta ndërprejë operimin normal të ndërmarrjes energjetike, apo të rrezikojë sigurinë e stabilimentit energjetik, sigurinë dhe pronën, jetën apo shëndetin e personave. Në veçanti është e ndaluar:

- a) Kryerja e çfarëdo pune në pronë/tokë, pa lejen e pronarit apo menaxherit të ndërmarrjes për energji;

- b) Ngritja e ndërtesave, objekteve, ndërtimeve apo kryerja e aktiviteteve të cilat do të pamundësonin apo vështirësonin mirëmbajtjen e objekteve energjetike, apo do të kërcënonin besueshmërinë dhe sigurinë e stabilimentit energjetik.

3.3. Çdo ndërtim, apo çdo punë e kryer në hapësirën e Zonës së Sigurisë i nënshtrohet miratimit paraprak me shkrim, nga menaxheri, apo pronari i stabilimentit energjetik. Ndërtimi i tillë duhet t'i përmbushë kushtet adekuate teknike dhe të sigurisë dhe nuk duhet të vë në rrezik jetën, shëndetin, apo sigurinë e personave.

3.4. Dispozitat e parashtruara në paragrafin 3.3 nuk e lirojnë pronarin, qiramarrësin, apo kujdestarin e tokës, që gjendet në Zonën e Sigurisë, nga veprimi në pajtim me dispozitat e parashtruara në:

- a) Rregulloren Nr. 2000/53, të datës 25 Shtator 2000 mbi Ndërtimin në Kosovë veçanërisht nenet 2, 3 dhe 5; dhe
- b) Rregulloren Nr. 2003/30, të datës 10 Shtator 2003 për shpalljen e Ligjit të miratuar nga Kuvendi i Kosovës për Planifikimin Hapësinor.

Neni 4

Ndërtimi, apo kryerja e çfarëdo pune tjetër, duke përfshirë mbjelljen e drurëve në tokat nën, mbi, apo afër objekteve, pajisjeve dhe instalimeve energjetike

4.1. Ndërtimi, apo kryerja e çfarëdo pune tjetër, duke përfshirë mbjelljen e drunjëve në tokën nën, mbi, apo afër objekteve, pajisjeve dhe instalimeve energjetike, janë të ndaluara, në qoftë se ato do të ndikojnë në procesin e prodhimit, bartjes dhe distribuimit të energjisë, apo do të mund të rrezikojnë sigurinë e njerëzve dhe të pronës.

4.2. Nëse pronari, qiramarrësi, apo kujdestari i tokës që gjendet në Zonën e Sigurisë, ka dështuar në përmbushjen e obligimit për largimin dhe prerjen e

drunjëve, apo të vegjetacionit, pas kërkesës paraprake me shkrim nga menaxheri, apo pronari i ndërmarrjes energjetike; ky i fundit fiton të drejtën për largimin apo prerjen e drunjëve dhe bimëve të tjera që rrezikojnë sigurinë dhe rregullsinë e punës së ndërmarrjes energjetike.

4.3. Cilado ndërmarrje energjetike që largon vegjetacionin, apo drunjët nga Zona e Sigurisë, sipas dispozitave të parapara në paragrafin 4.1, duhet të:

- a) Ketë qasje të lirë në tokën ku gjendet vegjetacioni, apo drunjët dhe
- b) Mbulojë të gjitha shpenzimet për një punë të tillë.

4.4. Ndërmarrjet energjetike janë përgjegjëse për çfarëdo dëmi të shkaktuar në pronë, sipas kushteve të parapara në ligjet e zbatueshme në Kosovë.

Neni 5

E Drejta e Qasjes

5.1. Ndërmarrjet energjetike kanë të drejtë ligjore për qasje në tokat brenda Zonës së Sigurisë.

5.2. E drejta e qasjes, e paraparë në paragrafin 5.1, nuk i nënshtrohet kompensimit për pronarin, qiramarrësin, apo kujdestarin e tokës brenda Zonës së Sigurisë.

Neni 6

Zonat e Sigurisë rreth Stabilimenteve të Energjisë Elektrike

6.1. Zonat e Sigurisë janë të vendosura përreth stabilimenteve të energjisë elektrike për t'i mbrojtur instalimet e prodhimit, apo centralet e energjisë elektrike, si dhe rrjetat dhe instalimet ndihmëse, rrjetin e bartjes dhe stacionet e tij transformuese, rrjetin e distribuimit dhe stacionet e tij transformuese, pajisjet e konsumatorëve të kyçur drejtpërdrejt, linjat direkte, linjat për matje, sistemet për mbrojtje, kontroll, siguri, informim dhe telekomunikim. Zonat e Sigurisë rreth stabilimenteve të

energjisë elektrike përfshijnë tokën, hapësirën ajrore apo ujin që i rrethon instalimet e energjisë elektrike.

6.2. Zona e Sigurisë rreth stabilimenteve të energjisë elektrike është një shirit i vazhdueshëm, i shënuar nga rrafshet vertikale që shkojnë në distancën horizontale të matur perpendikularisht, rrafshit të bazës së objektit, në përputhje me rregullat dhe standardet e aplikueshme teknike.

6.3. Brenda Zonës së Sigurisë së stabilimentit të energjisë elektrike, pa lejen e pronarit apo menaxherit të ndërmarrjes së energjisë elektrike, është i ndaluar ndërtimi, kryerja e çfarëdo aktiviteti të gërmimit, mbushjes, prishjes, përmbytjes, ujitjes apo përmirësimit të tokës dhe mbjellja apo heqja e drunjëve dhe e vegjetacionit.

6.4 Përsa u përket linjave nëntokësore, brenda Zonës së Sigurisë, pa lejen e pronarit apo të operatorit të instalimeve elektrike është i ndaluar:

- a) Kryerja e veprimeve të gërmimit nën ujë, për të lundruar, apo për të lëvizur me spirancën e lëshuar, me zinxhirë, trungje apo rrjeta.
- b) Vendosja e shenjave të trafikut dhe bovave për lundrim apo për të shkatërruar apo deponuar akullin.

6.5. Përsa u përket linjave transmetuese ajrore Brenda Zonës së Sigurisë, pa lejen e pronarit, apo të menaxherit të instalimit të energjisë elektrike, është e ndaluar:

- a) Vozitja e makinave apo operimi i makinerisë, lartësia e të cilit, me apo pa ngarkesë, kalon distancën e përcaktuar sipas rregullave teknike;
- b) Ndërtimi i stallave, gardheve dhe vendeve të ujit për bagëtinë.

6.6. Përsa u përket linjave nëntokësore brenda Zonës së Sigurisë, pa lejen e pronarit, apo të menaxherit të instalimit të energjisë elektrike, është i ndaluar operimi i mekanizmave ndikuese në nivel të tokës, kryerja e punëve në thellësi, siç është përcaktuar sipas rregullave dhe standardeve të aplikueshme teknike.

6.7. Zona e Sigurisë për stabilimentin e energjisë elektrike mund të zgjerohet nga Ministria e Energjisë dhe Minierave (më tej “Ministria”), nëse rrezikshmëria, voltazha, kapaciteti dhe lokacioni i instalimit të energjisë elektrike kërkon një zgjerim të tillë. Ky vendim duhet të jetë i përkohshëm deri në tre (3) muaj dhe duhet t’i dërgohet me shkrim:

- a) Pronarit, qiramarrësit, apo kujdestarit të tokës;
- b) Autoritetit kompetent Komunal; dhe
- c) Ministrisë së Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor.

Neni 7

Zonat e Sigurisë rreth Sistemeve të Ngrohjes

7.1 Zonat e Sigurisë janë caktuar me qëllim të mbrojtjes së sistemit të integruar dhe të ndërlidhur të prodhimit, distribuimit dhe furnizimit të ngrohjes. Zonat e Sigurisë rreth sistemeve të ngrohjes përfshijnë, po ashtu, tokën dhe ujin përreth sistemit të ngrohjes.

7.2. Brenda Zonës së Sigurisë së sistemit të ngrohjes, pa lejen e pronarit apo menaxherit të ndërmarrjes së ngrohjes, është i ndaluar ndërtimi, gjurmimi, mbushja, prishja, përmytja, ujitja apo përmirësimi i tokës, dhe mbjellja apo prerja e drunjve dhe vegjetacionit.

7.3 Zona e Sigurisë është një shirit i vazhdueshëm i shënuar nga rrafshet vertikale që shkojnë në distancën horizontale të matur perpendikularisht, rrafshit të bazës së objektit dhe në pajtim me rregullat dhe standardet e aplikueshme teknike.

7.4 Dispozitat e parapara në paragrafin 7.3 nuk janë të aplikueshme ndaj objektit të distribuimit që kalon nëpër ndërtesat publike apo private. Megjithkëtë, kryerja e punëve ndërtimore apo riparuese në këto stabilimente i nënshtrohen dispozitave të parapara në nenet 3.3, 3.4, 8 dhe 9 të këtij Udhëzimi Administrativ.

Neni 8

Procedura lidhur me paraqitjen e kërkesës për ndërtimin në Zonën e Sigurisë

8.1. Pronari, qiraxhiu apo kujdestari i tokës që gjendet në Zonën e Sigurisë duhet t'i paraqesë menaxherit apo pronarit të stabilimentit energjetik kërkesën, e cila justifikon detajisht nevojën për ndërtimin në tokën që gjendet brenda Zonës së Sigurisë. Kërkesa e tillë ndër të tjera duhet:

- a) T'i specifikoj arsyet që justifikojnë një ndërtim të tillë;
- b) Të vërtetoj se ndërtimi i tillë respekton kushtet përkatëse teknike dhe të sigurisë dhe nuk rrezikon jetën, shëndetin apo sigurinë e personave.

8.2. Nëse është e nevojshme, dhe pas kërkesës me shkrim të menaxherit apo pronarit të stabilimentit energjetik, pronari, qiraxhiu apo kujdestari i tokës që gjendet në Zonën e Sigurisë duhet t'i definojë dhe propozojë masat e kërkuara mbrojtëse që do t'i zbatoj rreth ndërtimit brenda Zonës së Sigurisë dhe, nëse është e nevojshme, edhe mbi objektet, pajisjet dhe instalimet përkatëse.

8.3. Kopja e kërkesës për të cilën referohet në paragrafet 8.1 dhe 8.2. për qëllim informimi, duhet t'u dërgohet në mënyrë elektronike dhe të shkruar, Ministrit të Energjisë dhe Minierave (më tutje, "Ministri") dhe autoritetit kompetent Komunal.

8.4. Menaxheri, apo pronari i stabilimentit energjetik duhet të japë miratimin e vet për ndërtimin e paraparë, në formë të shkruar, brenda dy (2) muajve, pas dorëzimit të kërkesës. Kopja e miratimit duhet t'u dërgohet, për informim, Ministrit dhe autoritetit kompetent Komunal.

Neni 9

Ndërtimet e Paautorizuara në Zonat e Sigurisë

9.1. Çdo punë ndërtimore e paautorizuar, vazhdimi i ndërtimit, ndërtimi i gardhit (rrethojës), prerja e drunjëve, apo veprimtari tjetër që shkel dispozitat e parashtruara në nenet 6 dhe 7, duhet të evitohet, apo ndalohe.

9.2. Menaxheri, apo pronari i stabilimentit energjetik ka të drejtë të kërkojë nga pronari, qiramarrësi, apo kujdestari i tokës që gjendet në Zonën e Sigurisë, përmes njoftimit me shkrim dhe brenda afatit kohor, më së largu prej dy (2) javësh, ta ndalojë ushtrimin e veprimtarisë së paautorizuar sipas paragrafit 9.1.

9.3. Kopja e këtij njoftimi duhet t'i dërgohet, me qëllim informimi, autoritetit kompetent Komunal.

9.4. Nëse pronari, qiramarrësi, apo kujdestari i tokës që gjendet në Zonën e Sigurisë, vazhdon ta ushtrojë veprimtarinë e paautorizuar, apo nuk arrin ta mënjanojë ndërtimin e paligjshëm, ndërmarrja energjetike ka të drejtë të kërkojë nga autoriteti kompetent Komunal që ta evitojë ndërtimin e paligjshëm, apo ta ndalojë atë. Shpenzimet e këtij mënjanimi i bart pronari, qiramarrësi, apo kujdestari i tokës.

9.5. Nëse aktiviteti i paautorizuar ndërtimor, ngritja e ndërtesës, thurja e gardhit, prerja e drunjëve, apo veprimtaria tjetër e paautorizuar paraqesin kërcënim serioz dhe të drejtpërdrejtë për sigurinë e stabilimentit energjetik, për sigurinë e pronës, apo për jetën dhe shëndetin e personave, ndërmarrja energjetike ka të drejtë të ndërmerë masa të nevojshme për evitimin e këtij kërcënimi.

9.6. Pronari, qiramarrësi, apo kujdestari i tokës, i përballon shpenzimet.

9.7. Me gjithë dispozitat e parapara në paragrafin 9.5, personat përgjegjës për dëmet në objektet dhe pajisjet energjetike, apo kryerjen e paautorizuar të punëve ndërtimore, zhvillimit të ndërtimeve, thurjes së gardhit, prerjes së drunjëve dhe veprimtarive të tjera të paautorizuara që paraqesin kërcënim serioz dhe të drejtpërdrejtë për sigurinë e stabilimentit energjetik, sigurinë e pronës, apo për jetën dhe shëndetin e personave, duhet të jenë përgjegjës sipas dispozitave të Rregullores Nr. 2003/25, mbi shpalljen e Kodit të përkohshëm Penal të Kosovës dhe të

Rregullores Nr. 2004/19, që amendamenton Kodin e përkohshëm Penal të Kosovës, si dhe ligjeve të tjera të aplikueshme në Kosovë.

Neni 10

Informimi

10.1. Informimi i opinionit publikut, lidhur me regjimin e Zonave të Sigurisë, mund të detajzohet përmes ueb - faqes së Ministrisë, me qëllim të sigurimit të komunikimit dhe të informimit të nevojshëm mbi regjimin e Zonave të Sigurisë.

10.2. Nëse është e nevojshme, mund të krijohen programe edukative në nivelin komunal, me qëllim të parandalimit të neglizhencës dhe/apo abuzimeve mbi tokat e mbrojtura nga regjimi i Zonave të Sigurisë, në pajtim me dispozitat e parapara në këtë Udhëzim Administrativ.

Neni 11

Amendamenti dhe Modifikimi

11.1. Çfardo amendamenti, apo modifikimi i këtij Udhëzimi Administrativ duhet të bëhet nga Qeveria e Kosovës, me propozimit të Ministrit.

Neni 12

Hyrja në fuqi

12.1. Ky Udhëzim Administrativ do të hyjë në fuqi në ditën e miratimit të tij nga Qeveria e Kosovës dhe pas nënshkrimit nga Kryeministri i Kosovës.

Kryeministri i Qeverisë së Kosovës

Bajram Kosumi

Prishtinë, 27 Korrik 2005